



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

---

**V E N D I M**

**Nr.1878, datë 19.04.2012**

**Për**

**Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Eagle Mobile sh.a.**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 19.04.2012, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

**Fillimi i procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Eagle Mobile sh.a.**

**BAZA LIGJORE:**

1. Neni 49, neni 50 pika 1, neni 60 dhe neni 120 e vijues, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**Ligji nr. 9918**);
2. Neni 46 e vijues të Ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);

3. Rregullore nr. 18 “Për procedurat e zgjidhjes se mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;
4. Rregullore nr. 19 “Për Aksesin dhe Interkoneksionin, miratuar VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar;
5. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008,

## K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Shkresa e Neofone sh.p.k, me nr. 147Prot., datë 22.03.2012, (nr. 557 Prot. i AKEP, datë 26.03.2012) “*Për anulimin në mënyrë të njëanëshme të faciliteteve shoqëruese, të aksesit dhe interkoneksionit nga operatori fnt eagle mobile sh.a si dhe për percaktimin e tarifës së terminimit për thirrjetme origjinë nderkombëtare*”;
- Shkresa e Neofone sh.p.k., më nr. 122Prot datë 17.01.2012, “*Përgjigje e shkresës së Eagle Mobile sh.a me nr prot.65 datë 11.01.2012*”;
- Shkresa e Neofone sh.p.k., më nr.125 Port datë 24.01.2012, “*Në vijim të shkresës nr. 122 prot, të Neofone dhe përgjigje të shkresës së Eagle Mobile Sh.a me nr. 228 Prot. datë 19.01.2012, duke marrë në konsideratë edhe takimin dypalësh midis Neofone Sh.p.k dhe Eagle Mobile Sh.a*”;
- Shkresa e Neofone sh.p.k., nr. 134 Prot datë 20.02.2012, “*Për anulimin e faciliteteve shoqëruese të alokuara për Neofone Sh.p.k dhe ndërprerjen e shërbimit të interkoneksionit për terminimin e thirrjeve me origjinë rrjetet nderkombëtare*”;
- Shkresa e Neofone sh.p.k., nr. 137 Prot datë 23.02.2012, “*Për mosterminimin e thirrjeve të numrave të portuara nga rrjetet e tjera mobile në rrjetin Eagle Mobile me origjinë rrjetet nderkombëtare*”;
- Shkresa e Neofone sh.p.k., nr. 145 Prot. datë 12.03.2012, “*Për moslejimin për terminimin e thirrjeve të origjinuara nga shërbimi me kartë të parapaguar (OSHKP) dhe anulimin e faciliteteve shoqëruese të alokuara për Neofone Sh.p.k*”;
- Shkresa e Eagle Mobile sh.a., nr. 65 Prot. datë 11.01.2012, “*Njoftim mbi aplikimin e tarifës së re për thirrjet hyrëse nderkombëtare duke filluar nga data 01.02.2012*”;
- Shkresa e Eagle Mobile sh.a., nr. 228 Prot. datë 19.01.2012, “*Njoftim i tarifës së re për thirrjet hyrëse nderkombëtare duke filluar nga data 01.02.2012*”;
- Korrespondencat me postë elektronike (email) e shkëmbyer midis palëve.

- Procesverbali i seancës paraprake dëgjimore mes palëve Neofone sh.p.k. dhe Eagle Mobile sh.a., mbajtur me datë 10.4.2012, ora 11:00, në ambientet në AKEP,
  - Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (*Relacioni*);
  - si dhe,
- duke i'u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

## V Ë R E N:

Sipërmarrësi Neofone sh.p.k, me shkresën nr. 147Prot., datë 22.03.2012, (nr. 557 Prot. i AKEP, datë 26.03.2012) “Për anulimin në mënyrë të njëanëshme të faciliteteve shoqëruese, të aksesit dhe interkoneksionit nga operatori fnt eagle mobile sh.a si dhe për percaktimin e tarifës së terminimit për thirrjetme origjinë nderkombëtare”, sqaron se:

1. Neofone sh.p.k. ka lidhur Marrëveshjen e Interkoneksionit me Eagle Mobile Sh.a më datë 5 Tetor 2011 në Tiranë. Neofone ka aplikuar online për Autorizimin e Përgjithshëm dhe ka përmbushur kushtet e aplikimit më datë 12.03.2012. Gjithashtu, Neofone ka përmbushur detyrimin për paraqitjen e kontratave dypalëshe origjinale me operatorët jashtë R.SH. në lidhje me alokimin e Kodit ISPC, dhe interkoneksion dypalësh me teknologjinë TDM.

Eagle Mobile me shkresat nr. 65 Prot. datë 11.01.2012 dhe nr. 228 Prot. datë 19.1.2012, njofton Neofone “Aplikimin e tarifës së re për thirrjet hyrëse ndërkombëtar duke filluar nga data 01.02.2012”. Neofone sh.p.k. pretendon se në këtë njoftim Eagle Mobile ka kërkuar në mënyrë të njëanshme ndryshimin e tarifës së interkoneksionit për thirrjet me origjinë ndërkombëtare.

Neofone sh.p.k, ka dërguar përgjigje me shkresën nr. 122Prot. datë 17.01.2012, ku i kërkon të ketë zhvillim negociatash dy palëshe në zbatim të kuadrit rregullatorë.

Eagle Mobile, ka konfirmuar me anë të postës elektronike, takimin më datë 23 janar ora 11:00, të mbajtur në ambientet e EM. Në këtë takim, nuk u ra dakord për tarifën e terminimit për thirrjet ndërkombëtare në rrjetin Eagle Mobile. Ky i fundit nuk pranon të rinegociojë tarifën e njoftuar nëpërmjet shkresës me nr. 228 Prot. datë 19.01.2012.

Neofone sh.p.k. nuk ka fimosur Amendamentin e Marrëveshjes së Interkoneksionit, pasi tarifat e paraqitura nga EM ishte 21 Lek/min, vlerë e cila është dyfishi më e lartë se ajo pararendëse që ishte 8.85 Lek/min dhe gati katërfishi i kostos reale të EM përcaktuar nga metodologjia BULRAIC.

Neofone sh.p.k ka dërguar shkresën me nr. 125 Prot.datë 24.01.2012, në këtë shkresë Neofone e fton përsëri në një raund të dytë negociatash operatorin FNT EM, në zbatim të kuadrit rregullator, ku rishprehet dhe mosdarkortësinë me tarifën e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare 21 Lekë/min. Eagle Mobile nuk kthen përgjigje.

Më datë 8 shkurt 2012, operatori FNT - EM pa njoftuar në mënyrë të njëanëshme ka anuluar kapacitetin minimal 2 Mbps në shërbim të Neofone për disa orë. Neofone sh.p.k. ka njoftuar për ndërprerjen nëpërmjet postës operatorin EM. Në përgjigje të njoftimit të

Neofone, operatori EM, ka mohuar faktin duke e rialokuar përsëri kapacitetin e bllokuar dhe ka ftuar Neofone në një takim urgjent po atë ditë. Ky takim i mbajtur në datë 08.02.2012 ora 14:00 nuk ka dhënë asnjë rezultat.

Më datë 16 Shkurt 2012 operatori EM Sh.a ka marrë masë ekstreme të anulimit të 'faciliteteve shoqëruese' dhe ndërprerjen e shërbimeve të interkoneksionit për terminimin e thirrjeve ndërkombëtare pëer operatorin Neofone Sh.p.k. Neofone Sh.p.k më datë 16 shkurt 2012 ka njoftuar operatorin FNT EM për shkeljen e "faciliteteve shoqëruese" dhe ndërprerjen e aksesit dhe interkoneksionit për shërbimet e përfshira në MI midis palëve. Neofone Sh.p.k më shkresën nr. 134 Prot. datë 20.02.2012, "Për anulimin e faciliteteve shoqëruese të alokuara për Neofone Sh.p.k dhe ndërprerjen e shërbimit të interkoneksionit për terminimin e thirrjeve me origjinë rrjetet ndërkombëtare" ai i ka kërkuar operatorit FNT EM të rihapë qarqet e bllokuara dhe ndalimin e shkeljeve në dëm të operatorit Neofone. Operatori EM nuk i përgjigjet përsëri shkresës së Neofone nr. 134 Prot., datë 20.02.2012.

Neofone sh.p.k. ka dërguar shkresën nr. 137 Prot., datë 23.02.2012, 'Për mosterminimin e thirrjeve të portuara nga rrjetet e tjera mobile në rrjetin Eagle Mobile me origjinë rrjetet ndërkombëtare". Operatori EM nuk i përgjigjet përsëri shkresës së Neofone nr.prot 137 datë 23.02.2012.

Neofone ka dërguar shkresën nr.. 145 Prot. datë 12.03.2012, "Për moshapjen e shërbimit të interkoneksionit për terminimin e thirrjeve të origjinuara nga shërbimi me kartë të parapaguara (OSHKP) dhe anulimin e faciliteteve shoqëruese te alokuara për Neofone Sh.p.k". Nga gjithë korrespondenca e drejtuar me EM nuk ka pasur anjë reagim nga operatori EM, duke injoruar plotësisht çdo praktikë ligjore.

Aktualisht operatori EM vazhdon të mbajë të mbyllur qarqet e interkoneksionit me kapacitet minimal 2 Mbps për Neofone duke lënë vetëm 15 kanale të ahpara për shërbimin e terminimit të thirrjeve kombëtare dhe asnjë kanal të hapur për terminimin e thirrjeve të origjinuara nga rrjetet ndërkombëtare.

Neofone, bazuar në dispozitat e ligjit nr. 9918, operaon si tranzitues dhe bartës i trafikut me origjinë ndërkombëtare dhe si operator i licensuar për telefoni fikse. Neofone bashkëpunon me palë të treta duke u ofruar mundësimin e terminimit të trafikut të tyre në rrjetin e EM, si dhe përmbush misionin e krijimit të konkurrencës efektive në tregun shqiptar për shërbimin e terminimit, në të cilin EM është OFNT. Sjellja e EM, duke bllokuar aksesin dhe interkoneksionin në qarkun E1 në mënyrë të njëanshme, është në kundërshtim me parimet e konkurrencës se ndershme të parashikuara në ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", duke shfrytëzuar pozitën FNT. Kjo bëhet me qëllim tkurrjen e tregut të lirë të konkurrencës duke zbatuar politika të diskriminimit dhe abuzimit me pozitën FNT.

Neofone, është detyruar të vuaje financiarisht mbylljen e qarqeve të interkoneksionit nga EM, si dhe kosto të tjera si prishja e imazhit dhe kontratave komerciale me operatorë jashtë vendit.

Në kushtet kur konsensusi për tarifën nuk është në vullnet të lirë të të palëve dhe operatori FNT mbyll aksesin dhe interkoneksionin dhe vendos një tarifë jo të orientuar në kosto (*ose nuk provon të kundërtën*) palët i drejtohen AKEP.

2. Në përfundim, Neofone duke iu referuar neneve 60, 61, 120, 135 dhe 137, kërkon nga AKEP:
  1. Të zgjidhë urgjentisht mosmarrëveshjen me Eagle Mobile, me qëllim minimizimin e kostove të shkaktuara ndaj Neofone në mënyrë të padrejtë e abuzive dhe në kundërshtim me kuadrin rregullator, si dhe sanksionimin e veprimeve antiligjore të EM.
  2. Të urdhërojë urgjentisht hapjen e aksesit në facilitetet aktuale mes Neofone dhe EM, dhe anulimin e nderprerjes së njëanshme së terminimit si për trafikun kombëtar ashtu edhe atë ndërkombëtar, për një shfrytëzim sa më eficient të faciliteteve.
  3. Të specifikojë qartë kushtet (*modalitetet*) e interkoneksionit mes Neofone dhe Eagle Mobile, duke parandaluar dhe specifikuar qartë mosndryshimin e aksesit për terminimin dhe facilitetet shoqëruese (*praktikë që ndiqet gjerësisht nga EM duke limituar numrin e kanaleve dhe qëllimin e përdorimit të tyre, dhe duke krijuar barriera artificiale në zhdukjen e konkurrencës*), me qëllim shmangien e çdo keqkuptimi mes palëve. Modalitetet nënkuptojnë detyrimin e EM për mosdiskriminim të trafikut kombëtar dhe ndërkombëtar në facilitetet e dhëna, tarifat e padrejta në këto facilitete si dhe ndryshimin e çmimit në periudha të shkurtra me qëllim përfitim të pandershëm dhe çorientim të tregut dhe konkurrencës së lirë.
  4. Përcaktimin e tarifës së terminimit të thirrjeve ndërkombëtare në rrjetin e Eagle Mobile, në përmbushje të ligjit nr. 9918, kjo tarifë të jetë: (1) e orientuar në kosto dhe (2) jo më lartë se mesatarja e BE-së.
  5. Të ndërmarrë sanksione ligjore të nevojshme administrative në vlerësimin e shkeljes së bërë nga EM në zbatim të neneve 60, 135 dhe 135 të ligjit nr. 9918, duke marrë masa konkrete administrative.
3. AKEP, më datë 10.4.2012, ora 11:00, zhvilloi një seancë paraprake me palët, me qëllim sqarimin e çështjeve në lidhje me shqyrtimin e mosmarrëveshjes për anulimin e faciliteteve dhe përcaktimin e tarifës së terminimit për thirrjet me origjinë ndërkombëtare në rrjetin e EM. Palët në këtë takim mbajtën të njëjtin qëndrim, të parashtruar më parë në pretendimet e tyre, ku Neofone insiston për një tarifë të orientuar në kosto dhe të përcaktuar nga AKEP, dhe Eagle Mobile insiston se zbaton kuadrin rregullator.
4. Në përfundim, duke qenë se Neofone sh.p.k. dhe Eagle Mobile sh.a. megjithë përpjekjet e bëra mes tyre edhe me ndërhyrjen e AKEP, nuk kanë arritur të bien dakord për tarifën e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare në rrjetin e EM, dhe si pasojë moslidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit, AKEP, në zbatim të nenit 50 dhe në vijim të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, zgjidhja e mosmarrëveshjes midis sipërmarrësve mund të kryhet në bazë të kërkesës së një sipërmarrësi apo me iniciativën e AKEP,

## **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të Ligjit nr. 9918, nenin 46 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

## **V E N D O S :**

1. Të fillojë procedimin administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Neofone sh.p.k. dhe Eagle Mobile sh.a.;
2. Të ngrihet komisioni për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me përbërje si:
  - Altin Rrapaj Kryetar
  - Jonida Gjika Anëtar
  - Përparim Buçaj Anëtar
  - Esmeralda Dervishi Anëtar
  - Dritan Malaj Anëtar
3. Të njoftohen palët e interesuara Neofone sh.p.k. dhe Eagle Mobile sh.a. për fillimin e procedimit administrativ;
4. Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e Vendimit;
5. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al)

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R I**

**Piro XHIXHO**

## **ANËTARË:**

1. Alban KARAPICI
2. Alketa MUKAVELATI
3. Benon PALOKA
4. Zamira NURÇE